



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 129 prot.

Kamëz, më 10.11.2021

V E N D I M

Nr. 102 Datë 10 / 11 2021
PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E PROÇEDURËS DHE
RREGULLAVE TË ZHVILLIMIT TË SHORTIT PËR PËRFITIMIN E BANESAVE NË
PALLATET E RINDËRTUARA PËR SHKAK TË TERMETIT TË DATËS 26.11.2019.**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 10.11.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim **Projekt –Vendim Nr.93 Datë 10.11.2021** në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, aktin nr. 09 datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” dhe aktet nënligjore për zbatim të tij, Vendimin Nr. 750, Datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, Vendim Nr. 904, Datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, i ndryshuar, Vendimit Nr.5, Datë 06.01.2020 i ndryshuar, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, Vendimit Nr.22, Datë 13.02.2020, të Këshillit Bashkiak Kamëz, “Për miratimin e manualit të procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 468, Datë 10.6.2020, “Për Shpalljen e Zonës së Re për Zhvillim, në Fshatin Valias, Bashkia Kamëz dhe Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si Njësi Zbatuese”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I :

1. Miratimin e Rregullores për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të zhvillimit të shortit për përfitimin e banesave në pallatet e rindërtuara për shkak të tërmetit të datës 26.11.2019, rregullorja e përcaktuar paraqitet në Aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
2. Këshilli Bashkiak ngarkon për zbatimin e këtij vendimi Drejtorinë e Rindërtimit, Drejtorinë e Përgjithshme të Punëve Publike, Drejtorinë e Çështjeve Ligjore, Liçensave



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

dhe Kadastrës, Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit, Drejtorinë e Financës dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Kryetar Këshilli
Hysen Koldashi

